

STILI DHE FIGURA E PERSONIFIKIMIT DHE METAFORA NË VEPRËN “VETMIA” E MIGJENIT DHE “ALONE” E EDGAR ALLAN POP-S

Erëza RUSHITI¹

¹Department of English Language, Faculty of Foreign Languages, AAB College

²*corresponding author e-mail: ereza.rushiti@universitetiaab.com

Përmbledhje

Ideja të bën gjithmonë të veçantë – si ajo i spikat ndjenjat në raport me ngjarjet mbetet çështje studimi ndër breza. Situatave të pakënaqshme në shoqëri, gjendjes emocionale, ndjenjave herë-herë të ndrydhura kurthërimit të së ligës, zhdukjes së saj, momenteve gazmore të cilave nganjëherë ndiejmë sikur janë të çastit, të përkohshme apo se nuk zgjasin shumë, ndjenjës së vetmisë, këndvështrimeve të ndryshme nuk i është munguar asnjëherë motivi i shkrimtarëve për të kapur pendën dhe shpalosur tregimet një nga një lidhur me to.

Dy prej të tillëve shkrimtarë e poetë, dashës të pendës e bartës të artit letrar, janë Migjeni i letërsisë shqipe dhe Edgar Allan Poe i asaj amerikane ku me poezitë e tyre “Vetmia” dhe “Alone”, pasqyrojnë realitetin e tyre në forma të ndryshme – njëri me një vepër ku flet për pjesë më personale të jetës dhe tjetri me një vepër ku tema e trajtuar ka të bëjë me shoqërinë, rrethin dhe klasës sunduese, përkatësisht me gjendjen e rëndë të popullit dhe varfërisë së theksuar. Derisa trajtojnë tema të tilla, mundohen ta përçojnë ndjenjën dhe mesazhin deri tek lexuesi, duke e vënë atë në pozitën e tyre, për të ndjerë atë çfarë ata kanë ndjerë dhe, me anë të fjalëve e shprehjeve poetike, ta paramendojë dhe shohë botë në një këndvështrim tjetër.

Fjalë kyçe: *stil, figurë stilistike, Vetmia, Alone, personifikim, metaforë, Migjeni, Edgar Allan Poe.*

1. Hyrje

Ideja të bën gjithmonë të veçantë – si ajo i spikat ndjenjat në raport me ngjarjet mbetet çështje studimi ndër breza. Kurthërimit të së ligës, zhdukjes së saj, ndjenjave herë-herë të ndrydhura, momenteve gazmore që në çast të ikin nuk i është munguar asnjëherë motivi i shkrimtarëve për të kapur pendën dhe shpalosur tregimet një nga një lidhur me to. Dy prej të tillëve, dashës dhe bartës të artit, janë Migjeni i letërsisë shqipe dhe Edgar Allan Poe i asaj amerikane me poezitë e tyre “Vetmia” dhe “Alone,” poezi këto jo të vetmet ku sipas pikëpamjeve pasqyrohet realiteti i të dy autorëve, me ç’rast këta të fundit derisa trajtojnë tema të tilla mundohen që edhe ne si lexues të na vënë në pozitën e tyre, të ndiejmë atë çfarë ata kanë ndjerë dhe, me anë të fjalëve e shprehjeve poetike, ta paramendojmë sesi do të ishte po të ishim në vend të tyre.

Si një prej figurave më të shquara të letërsisë shqiptare, Migjeni thaujse gjithë jetën e tij gjatë karrierës si shkrimtar iu kushtoi shkrimeve me tema që trajtojnë kryesisht varfërinë e madhe nga kushtet e krijuara gjatë asaj kohe. Në themel të veprimtarisë së tij, pra, qëndron aspirata për një botë të re, ku njerëzit e thjeshtë të jetojnë të lumtur me dinjitet njerëzor dhe pa frikë për të nesërmen.

Edgar Allan Poe dhe veprat e tij, në anën tjetër, shfaqet në të gjithë kulturën popullore në letërsi, muzikë, filma dhe televizion. “Vetmia” depërton te lexuesit me tematikë të errët të frymëzuar nga ngjarje tronditëse të jetës së tij dhe efektet e të qenët i vetmuar. Aspekti psikologjik dhe ndikimi i tij në aspektin social, drejt ndryshimeve të jashtme shoqërore në "Alone", dhe ideja për të ndryshuar gjërat e gabuara deri në kuptimin e përgjithshëm, botën, dhe lufta ndaj të keqes dhe padrejtës tek "Vetmia" janë dhe mbetet motivi i përzgjedhjes së bërë për zhvillimin e punimit.

2. Prezantimi i veprave

2.1. “Vetmia” e Migjenit

“Vetmia” bën pjesë në grupin e poezive e poemave të autorit që trajtojnë gjendjen e përkeqësuar dhe të rëndë të vendit si pasojë të së cilës kemi popullin të vuajtur. Poeti këtu u flet sendeve, ku kërkon të komunikojë, por që në asnjërën përpjekje nuk merr ndonjë përgjigje të duhur. Vetmia vjen si pasojë e përbuzjes, injorimit të atyre që gjithmonë konsideruan veten të lartë në sy të të tjerëve, kryesisht në sy të njerëzve të thjeshtë që bënë çmos për bukë të gojës dhe të kishin një jetë paqësore, por që kjo e fundit ishte larg realitetit.

Poezia:

Më plak mërzitja / që vetmia më sjell; / përbuzja, urrejtja / të gjith sendet m'i mbështjell / që kam shumë anmiq / të liq / në këto sende pa shpirt, / Nuk flasin. / As sy s'kanë. / Po mue më bahet / se aty janë / vetëm që të më plasin / zemrën. / Së paku, të më shajnë: / I mallkuem! / Së paku, të anë tallin: / I uruem! / Së paku, të më këndojnë: / -I yni zot! / Ose të më thonë: / - Jeton kot! / Të flasin, të flasin se fjalë due / në këtë vetmi me ndigjue. / Ose të më tregojnë historinë / e tyne, autobiografinë: / ndoshta ty do gjej gjasim / me jeten teme pa tingllim / që në vetmi po e kaloj - / dhe s'po dij a rroj e s'rroj. / Sendet heshtin. - sa të pamëshirë! / Më bajnë dhe mue të hesht me pahirë, / pse gojë s'kanë / dhe nuk flasin, / aty janë / vetëm të më plasin / zemrën teme që po vuen / dhe në mërzi vetveten truen.

(poezia marrë nga interneti: Vetmia, Poezi nga Migjeni, Tekste Shqip)

2.2. “Alone” e Edgar Allan Poe-s

I ballafaquar me tragjedi të ndryshme në jetën e tij, braktisjen e babait, humbjen e nënës që në moshën dy-vjeçare, jeton një jetë të vështirë si fëmijë, i vetmuar dhe pa ndonjë përkrahje. Gjendja shëndetësore jo e mirë e vëllaut të madh dhe vdekja e tij ishin arsyeja kryesore që filloi të merrej me shkrime në të cilat shfaq ndjenjat e vërteta. “Alone” është ndër poezitë më personale të poetit, me temë të errët ku shpalos ndjenjat për fëmijërinë e humbur si pasojë e së cilës edhe ngjarjet apo momentet më të bukura nuk mund t'i përjetojë njësoj. Ajo është e strukturuar në atë mënyrë që prek të kaluarën duke kaluar në të tashmen.

Poezia:

From childhood's hour I have not been / As others were—I have not seen / As others saw—I could not bring / My passions from a common spring— / From the same source I have not taken / My sorrow—I could not awaken / My heart to joy at the same tone— / And all I lov'd—I lov'd alone— / Then—in my childhood—in the dawn / Of a most stormy life—was drwën / From ev'ry depth of good and ill / The mystery which binds me still— / From the torrent, or the fountain— / From the red cliff of the mountain— / From the sun that 'round me roll'd / In its autumn tint of gold— / From the lightning in the sky / As it pass'd me flying by— / From the thunder, and the

storm— / *And the cloud that took the form / (When the rest of Heaven was blue) / Of a demon in my view—*

(poezia marrë nga interneti: American Poetry: The Nineteenth Century, 1993)

3. Stili

3.1. Stili në poezinë “Vetmia” e Migjeni-t

E shkruar në stilin e mesëm dhe të lartë, “Vetmia” me anë të “sendeve që s’flasin” përshkruan të pasuruarit e regjimit të asaj kohe me ç’rast i mllëfosur, autori shfaq ndjenjat për gjendjen e rëndë nga situata e krijuar. Jeta është skena, dhe vuajtja e mjerimi protagonistë kryesorë.

- *Më plak mërztija / që vetmia më sjell; / përbuzja , urrejtja / të gjith sendet m’i mbështjell*

Përbuzja e urrejtja: nënvijëzohen shtresat dhe masat e ulëta, ato që shtypen, shfrytëzohen e malltretohen vetëm se janë njerëz që bëjnë jetë të thjeshtë. Migjeni paraqet gjendjen thellë të rënduar nga sundimi i monarkisë çifligaro-borgjeze. Nënçmimi, **përbuzja** që u bëhet është jonjerëzore dhe e pafalshme.

Poeti “mallkon” gjërat përreth tij: *Nuk flasin. / As sy s’kanë. / Po mue më bahet / se aty janë / vetëm që të më plasin / zemrën.*

Trajtim i pashpirt e i pabarabartë spikatet nëpërmjet kësaj pjese: *që kam shumë anmiq / të liq / në këto sende pa shpirt.*

Ndërsa të privilegjuarit heshtin, shpresa asnjëherë. Megjithatë, autori i mllëfosun nga indiferenca sendet i quan si “të pashpirt”: *Sendet heshtin. - sa të pamëshirë! / Më bajnë dhe mue të hesht me pahirë, / pse gojë s’kanë / dhe nuk flasin, / aty janë / vetëm të më plasin / zemrën teme që po vuen / dhe në mërzi vetveten truen.*

3.2. Stili në poezinë “Alone” e Edgar Allan Poe-s

“Alone” gjithashtu i takon stilit të mesëm pasi që në këtë poezi kemi ngjarje më personale. Në fakt, kjo poezi konsiderohet si ndër më personalet e shkrimtarit. Folësi ynë fillon duke na treguar të gjithëve se si që kur ishte fëmijë pati përjetime të pakëndshme përfshirë vdekje e tragjedi, të përceptuarit ndryshe të jetës dhe emocioneve që as vetë autori Poe nuk e kupton se pse ndodhin. Ai pyet veten pse i sheh gjërat ndryshe duke ndikuar edhe në aspekte të tjera, si: pëlqime dhe mospëlqime ndryshe nga të tjerët, pikëpamje të ndryshme në situata të ndryshme, etj.

- *From childhood’s hour I have not been / As others were—I have not seen / As others saw—
I could not bring / My passions from a common spring— / From the same source I have not
taken / My sorrow—I could not awaken / My heart to joy at the same tone*

Këtu përshkruhet fëmijëria e humbur e Poe-s që ndikoi dhe në karakter duke ndryshuar pikëpamjet për gjërat përreth tij. Ai nuk u rrit si fëmijët e tjerë – gazmorë, të qeshtur e të lumtur në kohën e rinisë e tyre.

- *I could not awaken / My heart to joy at the same tone— / And all I lov’d—I lov’d alone—*

Asgjë nuk është e njëjtë. Pas të gjitha ngjarjeve, bota për Poe-n ka ndryshuar. Edhe ndjenjat më të bukura, duke përfshirë dhe atë të dashurisë, i përjetoj ndryshe. Kushëriri e tij me të cilën synonte martesën u sëmur nga turbekulozi dhe vdiq pas disa viteve.

- *From the red cliff of the mountain— / From the sun that ‘round me roll’d / In its autumn tint of gold—Maja e kuqe e malit, dielli, ngjyra (ari) e vjeshtës:* Poe na bën të mendojnë për të bukurat e natyrës, por pavarësisht bukurisë nga pamjet e saj, ngjyrat e vjeshtës, etj., për poetin gjërat prapë njësoj mbeten – lumturinë nuk mund ta gjejë as te natyra.

4. Figura e kuptimit dhe shprehjes: Personifikimi

4.1. Figura e personifikimit në poezinë “Vetmia” e Migjenit

Migjeni personifikon gjërat rreth tij të cilat në një mënyrë i fajëson për gjendjen e pakënaqshme. Flet me to ndërsa ato nuk i flasin. Më shumë na e tregon ne si lexues se si ndihet pasi nuk merr asnjë fjalë nga ata që duhet të marrë.

Më poshtë janë paraqitur disa vargje nga poezia në të cilat kemi figurën e personifikimit:

<p><i>Nuk flasin. / As sy s'kanë. / Po mue më bahet / se aty janë</i></p>	<p>Objektet nuk mund të flasin apo të kenë tipare të fytyrës si sy. Atyre mund vetëm t'u ndiesh praninë si objekte që janë, ndërkaq fjala është për të privilegjuarit që pavarësisht ekzistencës, indiferenca e tyre ndaj gjendjes bën të mendosh se me të vërtetë ata janë por realisht nuk “ekzistojnë”.</p>
<p><i>Së paku, të më shajnë: / I mallkuem! / Së paku, të anë tallin: / I uruem! / Së paku, të më këndojnë: / -I yni zot! / Ose të më thonë: / -Jeton kot! / Të flasin, të flasin se fjalë due / në këtë vetmi me ndigjue. / Ose të më tregojnë historinë</i></p>	<p>Gjësendet as nuk mund të shajnë, as të tallin, të këndojnë apo të thonë diçka. Në këtë rast, autori pret që shtresa e lartë, pra të pasurit, të cilët mund të ishin edhe fqinjët e tij më të afërt, t'i reagojnë në çfarëdo mënyre: tallje, këndim, sharje... çkado vetëm të mos heshtin por të flasin. Dhe kjo nuk ndodh.</p>
<p><i>Sendet heshtin. - sa të pamëshirë! / Më bajnë dhe mue të hesht me pahirë, / pse gojë s'kanë / dhe nuk flasin, / aty janë / vetëm të më plasin / zemrën teme që po vuen / dhe në mërzi vetveten truen.</i></p>	<p>1. Sendet heshtin – mosdhënia e përgjigjes, pra heshtja, vazhdon. 2. dhe nuk flasin, aty janë, vetëm të më plasin – pra në njëfarë mënyre tregohet dhe përshkruhet injoranca e atyre, të pangopur për pushtet, duke mos shprehur interesim apo shqetësim për njerëzit, pra popullin që vuan. Janë sa për të qenë, jo për t'i dalë në ndihmë dikujt.</p>

Në rreshtat e fundit të poezisë, përkatësisht vargjet e paraqitura në pjesën e tretë në tabelën mësipër, kemi të prishëm të njëjtin element me pjesë të tjera të theksuara:

“Mosreagimin” e sendeve/objekteve autori e zëvendëson me mosreagimin e shtresës sunduese, sikur ndodh për inat dhe me qëllim: *pse gojë s'kanë / dhe nuk flasin, / aty janë / vetëm të më plasin / zemrën teme që po vuen / dhe në mërzi vetveten truen.*

4.2. Figura e personifikimit në poezinë “Alone” të Edgar Allan Poe-s

“Alone” është më pak e personifikuar. Në vijim janë dhënë disa nga vargjet e poezisë ku pjesa në të cilën kemi këtë figurë tregon edhe një pjesë të historisë nga jeta e Poe-s.

<p><i>From ev'ry depth of good and ill / The mystery which binds me still—</i></p>	<p>Mystery which binds me still: Vështirësitë e jetës nga tragjeditë e humbjet që kanë çuar në vetë-izolim janë diçka që nuk mund t'i kontrollosh. Duke pyetur veten dhe duke mos kuptuar pse ndodh kjo, të humbet forca dhe s'mund të bësh asgjë. Kështu ndihet dhe Poe në këto vargje.</p>
--	---

5. Figura e kuptimit dhe e shprehjes: Metafora

5.1. Figura e metaforës në poezinë “Vetmia” e Migjenit

Migjeni jo vetëm se i personifikon sendet por edhe metaforizon me to. Në formë krahasimi ai ngjason sendet e thjeshta me “sendet” ekzistuese. Dëshira e madhe por vështirë e realizueshme për ndryshim e thëllon më shumë në mërzi dhe vetminë monotone. Me të hyrë në poezi, gjejmë metaforën.

<i>Më plak mërzitja / që vetmia më sjell;</i>	Më plak mërzitja: Gjendja e përkeqësuar zgjati më shumë se që ishte paramenduar. Sakrificat dhe lodhjet fizike e mendore i lodhën njerëzit. Poeti jo vetëm këtu, në këto vargje e në këtë poezi, por edhe në vepra tjera të tij shprehet se ndien “plakje para kohe”.
<i>ndoshta ty do gjej gjasim / me jeten teme pa tingllim</i>	Jetë pa tingllim: jeta të duket e pavlerë përderisa nuk mund të arrish synimet përfshirë këtu zhdukjen e pakënaqësive, në këtë rast shoqërore, aq më shumë padrejtësitë tjera që vijnë në jetë. Ndiheh sikur jeton kot, sikur nuk ke ndonjë qëllim të caktuar dhe thuajse lodhesh për asgjë.
<i>që kam shumë anmiq / të liq / në këto sende pa shpirt,</i>	Shumë anmiq, të liq, në këto sende pa shpirt: Shprehur dhe thënë haptaz për qeverisjen e asaj kohe që paraqitej armik i popullit të varfër e të mjëruar, faktor kryesor për ashpërsinë e lëvizjes së lirë të këtyre të fundit.

5.2. Figura e metaforës në poezinë “Alone” të Edgar Allan Poe-s

Metafora në poezinë “Alone” gjindet me anë të pamjeve të natyrës që krahasohen me të mirat e jetës. Përmenden vlerat karakterizuese të saj, si: vjeshta e artë, rrjedha e ujit, dielli, retë aty-këtu, e kështu me rradhë. Këto janë simbol i të bukurave të jetës, por që në rastin e Poe-s janë të pamjaftueshme për të rikthyer dhe shtuar lumturinë, gëzimin, apo dashurinë.

<i>Of a most stormy life—was drawn / From ev’ry depth of good and ill / The mystery which binds me still— / From the torrent, or the fountain—</i>	Jetë me stuhi: Në një moment të caktuar, e gjitha kjo është një mister që autori nuk e kupton dot, aq misterioze sa nuk e di se si të na e shpjegojë; Nga përroi apo mali: Pavarësisht si rrjedh uji, ashpër apo butë, gjërat nuk ndryshojnë. Vetmia mbetet vetmi.
<i>From the red cliff of the mountain— / From the sun that ’round me roll’d / In its autumn tint of gold—</i>	Figura të ndryshme artistike; maja e kuqe e malit, dielli, ngjyra (ari) e vjeshtës: Poe na bën të mendojnë për gjëra të bukura siç është natyra, rrjedhja e ujit, rrezja e diellit, etj. Me gjithë pamjet, ngjyrat e vjeshtës, etj. për poetin jeta prapë mbeten njësoj – lumturinë nuk mund ta gjejë as aty.

<p><i>From the lightning in the sky / As it pass'd me flying by— / From the thunder, and the storm—</i></p>	<p>Qielli i pastër që u pengua nga retë apo bubullima: Metaforë kjo që përfaqëson ngjarjet (ato jo të mira, negative) në jetën e tij dhe për faktin që nuk mund t'i kontrollojë dot. Gjithçka e bukur dhe e lumtur zbutet dhe zhduket ngadalë, pengohet nga e keqja.</p>
<p><i>And the cloud that took the form / (When the rest of Heaven was blue) / Of a demon in my view—</i></p>	<p>Reja që mori formën e djallit (në sytë e tij) kur i gjithë qielli ishte i kaltër: E kaltërta e qiellit u pengua nga një re e zakonshme, por që në sytë (pikëpamjen, mendimin, këndvështrimin) e Poe-s ishte formë “djalli”. Atje ku mund të shihje një qiell blu, ai shihte renë.</p>

6. Përfundime

Fjala “vetmi” po të merrej si term i thjeshtë do të ishte përkthim fjalë-për-fjalë i të dyja veprave. Me të dalluar në kontekst, nga rrethanat apo periudhat në të cilat është shkruar secila, në vete të dyja e mbajnë të njëjtën gjendje apo ndjenjë nga e cila nuk arrijnë të shpëtojnë asnjëri nga poetët në fjalë. Derisa “Alone” e kemi më personale, “Vetminë” e gjejmë edhe në kuptim më të përgjithshëm, që prek dhe përfshin edhe shoqërinë. Të dyja **që pikasin** aspektin psikologjik njerëzor.

- Bukuria dhe ironia e temës madhore të “Alone” – ajo e ndjenjës së izoluar, e ndryshme, e keqkuptuar – është ajo me të cilën shumë njerëz mund të lidhen, dhe vetë akti i shprehjes së këtyre ndjenjave përmes poezisë e lidh shkruesin me të tjerët që mund të ndihen njësoj.
- Gjendja e pakënaqshme, e rëndë dhe në mjerim e popullit, njerëzve tu derisa i shikon tek enden rrugëve me zemra të plasura nga realiteti i hidhur, papunësia e malltretimi i mundimshëm nga ata që nuk njohin njerëzi, e gjitha arrin në pikën ku ‘mbushet kupa’. Si mënyrë a formë për t’u shprehur dhe të shlirohesh sadopak nga mllef, duke mos marrë ndonjë përgjigje përveç heshtjes për të gjitha pyetjet që sillen në mendje, mbetet letra, vargjet, poezia.

Mospërfillja e asaj çfarë ndiejmë, nevoja e të shprehurit, shpesh-herë dhe mungesa e përkrahjes, dikush që të zgjat dorën apo thjesht është aty për të ofruar mbështetje, vërtetë të çon në pikën ku ata, detyrueshëm dhe pa dëshirë të quajtur si “armiq,” janë padyshim jo të mirëseardhur në botën tënde. Rrjedhimisht, përfundon vetëm në ndjenjën ekzistuese dëshpëruese, një gjendje kjo që kur nuk je i njonjë statusi më të lartë apo ndihesh më pak i fuqishëm në shoqëri, vazhdon e sjell plagë, pavarësisht se shpresa mbetet gjithmonë.

Referencat

- [1]. Academy of American Poets. Edgar Allan Poe. 25 qershor 2021 nga: <https://poets.org/poet/edgar-allan-poe>
- [2]. AMERICAN POETRY: THE NINETEENTH CENTURY (1993). *Alone by Edgar Allan Poe*. Poetry Foundation. 25 qershor 2021 nga: <https://ëëë.poetryfoundation.org/poems/46477/alone-56d2265f2667d>
- [3]. Tekste shqip. Migjeni, Biografia. 25 qershor 2021 nga: <https://www.teksteshqip.com/migjeni/biografia>
- [4]. Tekste shqip. Vetmia nga Migjeni. 25 qershor 2021 nga: <https://ëëë.teksteshqip.com/migjeni/poezi-100148.php>